

Gusht 2005

Shënime mbi plotësimin e FORMULARIT TË KËRKESËS NË PROCESIN E LIKUIDIMIT

Formularët e kërkesës duhet të nënshkruhen. Faksi apo kopjet do të pranohen por Komisioni i Likuidimit rezervon të drejtën për të kërkuar origjinalin në çfarëdo kohe. Preferohen formularët origjinal.

EMRI dhe ADRESA E PRETENDUESIT

PRETENDUESI është person fizik apo ligjor i cili ka kërkesë(sa) ndaj ndërmarrjes shoqërore.

Nëse jeni person fizik ju lutem shkruani në këtë kuti emrin e plotë, adresën postare dhe numrin kontaktues të telefonit, fiks dhe mobil, nëse kjo është e mundur.

Nëse jeni person ligjor ju lutem shkruani emrin tuaj të regjistruar (dhe çfarëdo emra tjerë alternativ), adresat postare të regjistruara, numrin e telefonit dhe emrin e personit kontaktues.

LLOJIN(JET) DHE SHUMËN(AT) E KËRKESËS(SAVE)

Kreditorët

Zgjedhni llojin(jet) që i përgjigjet më së afërti KËRKESËS(save) të bëra dhe shkruani shumën e plotë për secilin lloj. Nëse shumë e plotë është e përbërë nga më shumë se një artikull (p.sh disa fatura për të mira), bashkangjitni një listë të ndarë e cila i indentifikon artikujt e veçantë, vlerat e tyre dhe shumën e plotë, njëjtë siç është dhënë në formularë. Nëse nuk është e mundur në të gjitha rastet të jipet llogaria e saktë, atëherë shkruani një llogari të vlerësuar dhe përshkruani atë si një vlerësim.

Pronarët e aseteve

Ju lutem siguroni (në fletë të ndarë) detaje relevante të aseteve për të cilat pretendohet pronësia (numrat serik, vendndodhjen fizike, etj) në mënyrë që të mund të identifikohen fizikisht. Nëse është e mundshme, jepni gjithashtu një vlerësim të vlerave individuale të secilës pasuri.

Ju gjithashtu duhet të siguroni fakte të shkruara për të dëshmuar se ju e posedoni atë pasuri (aset) dhe tregoni se pse pasuritë janë me ndërmarrjen.

Pronësia e ndërmarrjes

Nëse besoni se jeni pronar i Ndërmarrjes (p.sh. aksionar) ju duhet të ofroni fakte mbi pronësinë tuaj, në veçanti (i) ligjet në bazë të cilave ju keni blerë aksionet (ii) kopjet e certifikatave të regjistrimit (iii) detajet e vlerës/pjesës që ju keni dhënë për aksionet (për shembull çfarëdo investimi apo borxhi që është dhënë për aksionet, përfshirë kopjet e

marrëveshjeve të tilla) dhe faktet e pagesës në të vërtetë p.sh transferove bankare (iv) fakte se aksionet janë lëshuar në mënyrë valide dhe se transformimi nga ndërmarrja shoqërore në shoqëri aksionare është bërë në mënyrë valide.

Kërkesat tjera

Ju lutem siguroni në një faqe të ndarë detajet e çfardo kërkesë ndaj ndërmarrjes e cila nuk është mbuluar ende nga cilado kategori e cekur më lartë. Aty ku është e mundshme, orfoni vlerën për kërkesën

PENGJET, HIPOTEKAT APO KOLATERALET TJERA

Ju lutem siguroni (në fletë të ndarë) detaje të mjaftueshme të aseteve mbi të cilat është kërkuar pengu/hipoteka (numrat serik, vendndodhjen fizike, etj) në mënyrë që të mund të identifikohen fizikisht. Nëse është e mundur, gjithashtu paraqitni një vlerësim të vlerave individuale të secilës pasuri (aset). Deklaro se si/ku është regjistruar dhe datat.

Bashkangjitni kopjet e kontratave të dhëna nga ndërmarrja që dëshmon hipotekën apo kolateralin dhe gjithashtu identifikoni asetet e dhëna si siguri për shumën e kërkuar.

Konfirmoni shumën e KËRKESËS që është e siguar nga kjo hipotekë /kolateral.

DOKUMENTET MBËSHTETËSE

Shkruani këtu një përmbledhje të dokumenteve që do ti bashkangjitni formularit në mbështetje të KËRKESËS(save) tuaj. Nëse ka hapësirë të pamjaftueshme për të paraqitur të gjitha dokumentet e bashkangjitura ju lutem përdorni një letër të ndarë. Ju lutem siguroni se çfarëdo dokumenti i ndarë është bashkangjitur mirë në formularin e ankesës.

MOS DERGO DOKUMENTE ORIGJINALE – bashkangjitë vetëm kopjet të cilat i keni vërtetuar si kopje të vërteta të dokumenteve origjinale mbi të cilat KËRKESA e juaj bazohet.

DEKLARATE MBI VERTETESINE

Ju lutem siguroni se kjo deklaratë plotësohet. Shkruani emrin e PRETENDUESIT (personi fizik/ligjor në emër të të cilit është kompletuar) dhe ndërmarrjes ndaj së cilës është bërë KËRKESA. Personi që nënshkruan duhet gjithashtu të japë emrin e plotë dhe, përveç në rastet kur nënshkruesi është gjithashtu pretendues, duhet të jipet dëshmia se ai apo ajo është në mënyrë të duhur i/e autorizuar të nënshkruaj në emër të PRETENDUESIT.

Vërejtje: Cilido person që me vetëdije paraqet kërkesë e cila është fals mund ndiqet penalisht.

CLAIM MONITORING (OFFICIAL USE ONLY)

(use as a separate front sheet for each claim, to be attached to the initial request for a claim form to be sent and then added to the completed claim form once received).

Enterprise name and reference

Name of applicant

Date claim form sent to applicant.

Date claim form lodged with the Liquidation Committee.

CLAIM REFERENCE NUMBER

CLAIM TYPE (coding required)

Claim received within time limit?

Preferential claim involved?

Pledge/Mortgage involved?

CLAIM REVIEWED BY: -

DATE REVIEWED

REVIEW NOTES

DATE ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF CLAIM SENT

CLAIM VALUES:

Value per creditor claim form

Value per Enterprise records

AMOUNT proposed to Claimant and APPROVAL BY:

DATE PROPOSAL SENT

DATE OF RECEIPT OF CLAIMANT'S AGREEMENT (plus details of claimant's bank account for any payment)

Payment paid - %

Payment paid – amount

Tax withheld

DATE OF DPAYMENT